



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 17, datë 27.02.2019

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT DHE NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË  
NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I FABRIKËS SË PASURIMIT TË  
KROMIT”, ME VENDNDODHJE NË SURROJ, BASHKIA KUKËS

Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Vllaznimi Deda Import Eksport” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit dhe ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i Fabrikës së Pasurimit të Kromit”, me vendndodhje në Surroj, Bashkia Kukës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Vllaznimi Deda Import Eksport” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 11, datë 09.09.2015, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALËUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

